

**AKT THEMELIMI
(KONTRATË)**

**I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“QENDRA DIDAKTIKE IVAN{QDI}”-Sh.p.k.**

NE të poshtëshënuarit :

1 - Ilirjan MURRJA, i biri i Mensurit, i datëlindjes 22.07.1960, lindur në Hotes/Dibër, banues në Njësinë Administrative Peshkopi, Rrethi Dibër, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit nr.personal/personal no. 100722005S, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

2 - Aida MURRJA, e bija e Hamziut i datëlindjes 16.05.1992, lindur në Bulqizë, banuese në Njësinë Administrative Peshkopi, Rrethi Dibër, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e kartës së identitetit nr.personal/personal no.J25516005S

Sot me datë 06.01.2022

V E N D O S Ë M

Neni 1

Të themelojmë një Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar për të ushtruar veprimtari ekonomike të EMËRTUAR : “QENDRA DIDAKTIKE IVAN{QDI}”-Sh.p.k.

Neni 2

Shoqëria do të jetë e formës së Shoqërive Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar dhe përballon humbjet deri në kufirin e vlerës së derdhur në kapitalin themeltar.

Neni 3

Shoqëria e ka SELINË në DIBER, PESHKOPI, Nj.Adm.PESHKOPI, Lagjja AKSION”, Rruga “Rahim Gjika”, Ndërtesa Nr.Pasurie 14/320-N2/pas kinemasë.

Ajo ka të drejtë të krijojë brenda dhe jashtë teritorit të Republikës së Shqipërisë, filiale, agjensi, përfaqësi, seli sekondare dhe t'i suprimojë ato.

Neni 4

Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje me një kufi të pacaktuar, mbi 15 vjet.

Neni 5

Kapitali Themelor i Shoqërisë do të jetë 1000 Lek (Njëmijë lek).

Kapitali i shoqërisë zotërohet nga Ortakë e shoqërisë, Ilirjan MURRJA dhe Aida MURRJA.

Ne ortakët Ilirjan MURRJA dhe Aida MURRJA, zotërojmë 100 % të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga 2 pjesë të vetme (Dy kuota) me vlerë nominale prej 500 Lek (Pesëqindlek) për secilën kuotë (pjesë).

Neni 6

Në librin e llogarisë që do të krijohet në Shoqërinë Tregtare do të shënohet dhe kapitali i derdhur nga Ortaku i Vetëm.Rritja e kapitalit nuk është e kufizuar.

Neni 7

Të gjitha pjesët e kapitalit themelor janë tërësisht të shlyeshme dhe të nënshkrueshme nga Ortakët e shoqërisë.

Neni 8

Objekti i veprimtarisë do të jetë si vijon :

Veprimtari në fushën e mësimdhënies gjatë procesit mësimor dhe atij shkencor sipas standarteve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve me qëllim përgatitjen e nxënësve me dije dhe formim bashkëkohor. Mësimdhënie në ciklin e ulët, të mesëm e të lartë duke zhvilluar mësim, kurse, trajnime, konsultime etj. Aplikimi dhe realizimi i dinamikave të reja të mbështetura në zhvillimet dhe ndryshimet ligjore e didaktiko shkencore që sjellin institucionet ligjvënëse brenda vendit dhe institucionet kërkimore shkencore brenda e jashtë vendit. Veprimtari në dhënien e shërbimeve të përkujdesit komunitar si kopshte fëmijësh etj. Import-Eksport, tregtimi i artikujve të ndryshëm i të gjitha llojeve me shumicë e pakicë, tregtimi i artikujve të ndryshëm, kryesisht mjete didaktike, pajisje shkollore, pajisje elektronike e të ngjashme me to.

Neni 9

Marëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit që lidhet midis palëve në mbështetje të Ligjit Nr.7961 Dt.12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", si dhe akteve të tjera nënligjore të dala në zbatim të tij.

Neni 10

Ortaku i Vetëm i shoqërisë nuk kufizohet në rritjen e kapitalit të shoqërisë.

Neni 11

Shoqëria vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejta e detyrime vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortaku i Vetëm Themelues mbart rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë vetëm në nivelin e kapitalit të investuar në shoqëri.

Neni 12

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë private të shoqërisë, midis punonjësve brenda saj dhe me të tretët, kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, atëherë ato zgjidhen me rrugë gjyqësore në gjykatën kompetente.

Neni 13

Shoqëria do të ketë vulën e saj ku janë përcaktuar dhe inicialet e emërtimit të shoqërisë.

Neni 14

Pasuria e shoqërisë mund të sigurohet pranë shoqërive të sigurimit duke respektuar ligjet që veprojnë në fushën e sigurimit dhe risigurimit.

Neni 15

Organet e Shoqërisë "QENDRA DIDAKTIKE IVAN{QDI}"-Sh.p.k.

- Asambleja e Ortakëve.
- Administratori/ët e Shoqërisë

Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre do të përcaktohen në Statutin e shoqërisë.


Administrator i shoqërisë do të jetë Z. Ilirjan MURRJA, zotërues i Kartës së Identitetit nr.personal/personal no. I007220055

Modalitetet për ndryshimin e Administratorit/ve si dhe kompetencat rregullohen nga Statuti i Shoqërisë dhe Ligji Nr 9901 Dt.14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".


Ky Akt Themelimi është përpiluar në katër kopje me vlerë të njëjtë me originalin dhe është nënshkruar me vetëdije dhe vullnet të plotë prej meje personalisht.

**THEMELUESI I SHOQËRISË TREGTARE“
“QENDRA DIDAKTIKE IVAN{QDI}”-Sh.p.k.**

Ilirjan MURRJA



Aida MURRJA



Peshkopi, 06 Janar 2022